



**FEDERATA SKITARE E KOSOVËS**  
**SKI FEDERATION OF KOSOVO**  
**SMUČARSKA FEDERACIA KOSOVA**  
www.fs-kos.com, email: info@fs-kos.com  
House of Sport – Prishtina  
Tel: +383 38 248 101, +383 49 501 091, +383 49 255 266

**Data:** 19.04.2024

Federata Skitare e Kosovës ka statusin e personit juridik, është e regjistruar si organizatë joqeveritare pranë MAP dhe bashkëpunon direkt me organet publike të Republikës së Kosovës, konkretisht me Departamentin e Sportit pranë Ministrisë për Kulturë, Rini dhe Sport, për realizimin dhe arritjen e krijimit të kushteve për zhvillimin e sportit të skijimit në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës. FSK në bazë të këtij statusi shpallë këtë:

**THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM TË KATËR EKSPERTËVE NDËRKOMBËTAR  
PËR HARTIMIN E STUDIMIT TË FIZIBILITETIT NË QENDRËN E SKIJIMIT  
NË BREZOVICË.**

Federata Skitare e Kosovës shpallë këtë thirrje publike për ekspertët ndërkombëtar, njohës të fushës së skijimit, si dhe me përvojë të dëshmuar për hartimin e studimit të fizibilitetit për qendrën e skijimit në Brezovicë.

Ekspertët që do të angazhohen do t'i kenë këto detyra dhe përgjegjësi:

1. Përshkrimi i gjendjes ekzistuese të zonës përpunuese - Brezovicë:
  - 1.1. Përshkrimi i situatës ekzistuese (veçoritë natyrore, rruga e hyrjes, rregullimi i jashtëm, infrastruktura ekzistuese e teleferikut, komunat shoqëruese ekzistuese, infrastruktura akomoduese, etj.)
  - 1.2. Kushtet klimatike;
  - 1.3. Aspekti i sigurisë njerëzore;
  - 1.4. Aspekti i mbrojtjes së mjedisit.
2. Vlerësimi i mundësive të zhvillimit të vendndodhjes dhe fizibilitetit:
  - 2.1. Infrastrukturën e nevojshme;
  - 2.2. Vendosja e pistave të skijimit;
  - 2.3. Përzgjedhja e teleferikut;
  - 2.4. Përzgjedhja e sistemit të borës artificiale për pista;
  - 2.5. Ndriçim për nevojat e skijimit gjatë natës;
  - 2.6. Pajisje të tjera (makinat e shkeljes, shitja/kontrolli i biletave, pajisjet mbrojtëse, shenjat në pistat e skive, mbrojtja nga ortekët, etj.)
  - 2.7. Rinovimi dhe ndërtimi i kapaciteteve akomoduese;

- 2.8. Rinovimin dhe ndërtimin e infrastrukturës komunale;
- 2.9. Përmbajtje të reja të mbrojtjes së mjedisit;
- 2.10. Burimet e rinovueshme të energjisë;
3. Koordinimi i lokacionit të caktuar me aktet hapësinore dhe zonat mbrojtëse të natyrës.
4. Analiza financiare e investimeve me çmime konstante dhe korrente.
5. Dinamika e ndërtimit - orari tentativ.
6. Burimet e financimit.
7. Struktura organizative dhe modeli i menaxhimit (kryhet në detaje në një studim të veçantë pas përcaktimit të klientit).
8. Analiza e tregut (oferta turistike, kërkesa).
9. Potencialet zhvillimore turistike (vetëm një rekomandim për ndërtimin e kapaciteteve të nevojshme turistike, i detajuar në një studim të veçantë sipas përcaktimit të klientit).

Ekspertët të cilët do të aplikojnë në këtë shpallje publike nga FSK, së bashku me ofertën e detajuar duhet të i bashkëngjisin edhe dokumentet e tjera siç janë:

- Dokumentacionin identifikues,
- CV-të,
- si dhe ofertën për punën që do t'a bëjnë.

- Kjo shpallje do të jetë e hapur për 15 ditë, respektivisht data e fundit e aplikimit është më 02 Maj 2023.

- Të interesuarit duhet të aplikojnë me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në emailin: [info@fs-kos.com](mailto:info@fs-kos.com).

- Shuma e planifikuar për angazhimin e ekspertëve ndërkombëtar për këtë projekt është 59,700.00€ (Pesëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind euro e zero cent).

- Federata Skitare e Kosovës do të shpallë njoftimin e fituesve pesë (5) ditë pas përfundimit të datës së aplikimit.